

(82)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Përmbledhje e Vërejtjeve dhe Rekomandimeve
ANALIZA E SHPENZIMEVE 2022 -2024

KOMISIONERËT PUBLIKË

A. Lista e Programeve

1. Veprimtaria e komisionerit publik

B. Komente të Përgjithshme

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar në VKM-në nr. 190, datë 03.03.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.
2. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga institucioni janë në përputhje me VKM-në nr. 190, datë 03.03.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.
3. Relacioni shoqërues, në zbatim të përcaktimit të pikës 4 të udhëzimit nr.8/2021 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, është paraqitur.
4. Institucioni i Komisionerëve Publikë nuk ka paraqitur kërkesë shtesë, të argumentuar në relacionin shoqërues, për arsye të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili përcakton se mandati i Komisionerëve Publik është 5 vjet nga data e fillimit të tyre dhe mandati i këtij institucioni përfundon në Qershor 2022.

C. Analiza e Kërkesave Buxhetore

Në relacionin shoqërues, paraqiten parashikimet buxhetore, të detajuara sipas zërave përkatës, brenda taveve të miratuara. Formatet janë plotësuar në përputhje me udhëzimin e sipërcituar. Më konkretisht, si më poshtë vijon:

- ✓ Formati nr. 1 “Misioni i njësisë së qeverisjes qendrore” është plotësuar.
- ✓ Formati nr. 2 “Formati standart i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2022-2024 - Politikat ekzistuese”, është plotësuar në përputhje me tavanet buxhetore të miratuara.
- ✓ Formati nr. 3 “Formati standart i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2022-2024 - Politikat e reja” nuk është plotësuar pasi institucioni nuk ka kërkesa buxhetore shtesë.
- ✓ Formati nr. 4 “Alokimi i Taveve për financimin e politikave ekzistuese për programet” është dorëzuar.
- ✓ Formati nr. 5 “Shpenzimet për financimin e politikave ekzistuese për projektet në vazhdim” është dorëzuar.

- ✓ Formati nr. 6 “Shpenzimet për projektet e reja të investimeve”, nuk është dorëzuar pasi institucioni nuk parashikon projekte të reja investimi.

Programi “Veprimtaria e komisionerit publik”

C.1 Formulimi i Qëllimit/Objektivave/Treguesve të Performacës

- Formulimi i Qëllimit të Politikës së këtij programi është realizuar përgjithësisht mirë. Është evidentuar një tregues performance në nivel qëllimi “Numër ankimesh ose mosankimesh të publikuara brenda afatit ligjor”. Treguesi është plotësuar me vlerën bazë dhe me vlerat e parashikuara për vitin 2022.
- Objektivi i politikës së programit është formuluar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me qëllimin e politikës. Është evidentuar një tregues performance në nivel objektivi i cili është plotësuar me vlera për vitin 2022.

C.1 Kërkesat shtesë të paraqitura në Relacionin Shpjegues

- Institucioni nuk ka kërkesa shtesë për arsye të mbarimit të mandatit të tij në Qershor 2022, përcaktuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili përcakton se mandati i Komisionerëve Publik është 5 vjet nga data e fillimit të tyre.